- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si

më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Mirëmbajtje Impjantesh Elektrike për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, është një kompleks spitalor, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 15.95 hektarësh, ku gjenden rreth 20 godina spitalore dhe ndërtesa të tjera ndihmëse.

Mirëmbajtja e rregullt e sistemit të furnizimit me energji elektrike, motogjeneratorëve dhe UPS, në një spital është thelbësor për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit, sigurinë e pacientëve dhe stafit, si dhe zbatimin e rregullave, kërkesave teknike, normativave dhe standarteve europiane në fuqi.

Këto rregullore përcaktojnë kriteret për të garantuar sigurinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e sistemit elektrik, me vëmendje të veçantë në mjediset kritike siç janë spitalet. Kërkesat kryesore përfshijnë dimensionimin e duhur të sistemit, përdorimin e materialeve të certifikuara dhe praninë e pajisjeve të avancuara mbrojtëse. Pajtueshmëria me rregulloret jo vetëm që mbron pajisjet, por gjithashtu siguron vazhdimësinë operative dhe zvogëlon rrezikun e incidenteve elektrike.

Mirëmbajtjet periodike synojnë të parandalojnë prishjet, të zgjasin jetëgjatësinë e sistemeve, të zvogëlojnë rrezikun e ndërprerjeve dhe aksidenteve dhe të optimizojnë konsumin e energjisë.

Një spital i rëndësishëm së veçantë si QSUT, e ka të domosdoshme dhe jetike që të sigurojë furnizim me energji të pandërprerë, pasi është thelbësor për funksionimin e:

- Pajisjeve shpëtimtare të jetës, siç janë ventilatorët, monitorët dhe pajisjet kirurgjikale.
- Departamenteve kritike, siç janë sallat e operacionit, njësitë e kujdesit intensiv dhe laboratorët.
- Sistemeve të sigurisë, siç janë alarmet e zjarrit, ashensorët dhe ndriçimi i emergjencës.
- Garantimin e jetës së pacientëve, pasi një ndërprerje e energjisë mund të rrezikojë jetën e pacientëve, duke kompromentuar operacionet mjekësore dhe duke shkaktuar ndërprerje serioze.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” (i përditësuar); QSUT e ka detyrim ligjor të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, pacientëve, familjarëve, studentëve, etj., nëpërmjet ndërmarrjes së masave parandaluese, gjithëpërfshirëse dhe koherente, të cilat mbulojnë teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës etj., me synim parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, në përputhje me ligjet dhe normativat në fuqi.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që sistemet të mirëmbahen rregullisht, të testohen dhe të kontrollohen periodikisht për defekte, në mënyrë që të jenë në gjendje optimale teknike dhe të kenë aftësinë për t'u aktivizuar menjëherë edhe në kushte të jashtëzakonshme emergjence (ndërprerje energjie nga rrjeti i shpërndarjes).

Kërkesa të përgjithshme:

Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemeve/pajisjeve objekt i kësaj procedure do të kryhet në përputhje me Normativat dhe Standartet elektrike kombëtare dhe ndërkombëtare (BE), legjislacionin në fuqi, Rregulloret e OST (Operatorit të sistemit të trasmetimit), Manualët e mirëmbajtjes së prodhuesve të këtyre sistemeve/pajisjeve, specifikimeve dhe kërkesave teknike të kërkuara.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme, si dhe të ketë licencën dhe eksperiencën e duhur për ekzekutimin e këtij objekti prokurimi, duke patur parasysh shërbimet e kërkuara në Preventivin e Ofertës si dhe “Specifikimet teknike”.
- Operatori ekonomik, duhet të njihet me preventivin e punimeve, gjendjen faktike të këtyre sistemeve, (kabina, motogjeneratorë, UPS) dhe në tërësi të skemës së shpërndarjes së energjisë elektrike në çdo godinë të QSUT dhe të deklarojë me shkrim që merr përsipër riparim-mirëmbajtjen e tyre sipas kushteve të kërkuara.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë në organikë staf të specializuar/kualifikuar inxhinier elektrik ashtu edhe teknik elektrikist, profesionalisht kompetent për kryerjen e mirëmbajtjes dhe riparimin e çdo

defekti të mundshëm që mund të kenë këto sisteme/pajisje duke patur parasysh sistemet dhe zërat e preventivuar.

- Operatorit Ekonomik të mirëmbajtjes i kërkohet të sigurojë gadishmëri teknike 24 orë/365 ditë në raste defektesh kritike, qoftë ditë të shtunë, të diela apo feste zyrtare. Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:30 ditë pune apo pushimi, në kohë të përshtatshme pa penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
- Operatori ekonomik do të caktojë nga stafi i tij një person përgjegjës të sigurisë në punë, person përgjegjës inxhinier elektrik dhe teknikët elektrikist, të cilët do të përgjigjen për riparimin e defekteve në çdo kohë 24 orë/24, brënda dhe jashtë orarit zyrtar të kohës së punës, në çdo ditë të javës, qoftë ditë pushimi apo ditë feste zyrtare.
- Operatori ekonomik, duhet të kontaktojë çdo ditë me përfaqësuesit e QSUT, personat përgjegjës të Sektorit Teknik, për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ku do të raportojë për anomali apo defekte nëse ka patur dhe do të marrë udhëzimet.
- Operatori Ekonomik do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas “Urdhrave të punës”, të lëshuar nga përfaqësuesi i Sektorit Teknik të QSUT. Riparimet e çastit, emergjente, duhet të kryhen menjëherë me marrjen e njoftimit.
- Operatori Ekonomik angazhohet të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes në një kohë sa më të shkurtër, për të bërë të mundur një kohë sa më minimale të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike kur kjo të jetë e domosdoshme.
- Në rast ndërprerje të energjisë elektrike, OE duhet të njoftojë menjëherë stafin elektrik të QSUT dhe të jetë në shërbim të asaj godine ku ka avari, duke bërë manovrimet e duhura në bashkëpunim me stafin elektrik të QSUT si edhe me specialistët e OSHEE Shpërndarje.
- Operatori Ekonomik duhet të marrë përsipër që, në rast madhor të një defekti të rëndë të djegies së një transformatori, të japë furnizim me energji duke montuar transformatorin rezervë që disponon QSUT, në bashkëpunim me specialistë të energjitikës.
- Cilësia e shërbimit të kërkuar dhe shpejtësia e ndërhyrjes për riparimin e defekteve është parësore, pasi vetë natyra e shërbimit të ofruar nga Q.S.U.T është delikate dhe shumë e ndjeshme.
- Të gjitha produktet/materialet/pjesët që do të përdoren për furnizim vendosje duhet të jenë të reja, të çertifikuara (CE), ekuivalente dhe në përshtatje me pajisjen/sistemin.
- Garancia e pjesëve të këmbimit, kërkohet të jetë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga data e kryerjes së furnizim/vendosjes dhe/ose sipas afatit të garancisë së prodhuesit për pjesën.

Mirëmbajtja e Impjanteve Elektrike përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e:

I. Sistemit të furnizimit me energji elektrike të çdo godine,spitalore dhe teknike

- Kabinat elektrike 20/6/0.4 kV, sipas listës bashkëngjitur
transformatorët
panelet elektrike
sistemet e mbrojtjes kundër mbingarkesave dhe qarqeve të shkurtra.
- Kuadrot kryesoretë shpërndarjes së energjisëderi në hyrje të godinës (ambientet teknike kati minus 2 dhe minus1 i godinave).
- Blindosbarrat (në godinat që kanë sistem të tillë).

II. Motogjeneratorët, sipas listës bashkëngjitur;

III. UPS, sipas listës bashkëngjitur.

I. SISTEMI I FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Specifikimet dhe Kërkesat Teknike

Preventivi për Mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me energji të QSUT është grupuar në 2 nën-ndarje, mbështetur në mënyrën e projektimit dhe funksionimit të skemës/sistemit të furnizimit me energji elektrike të objekteve/godinave spitalore.

I/A. Sistemi i furnizimit me energji elektrike i objekteve ekzistuese dhe atyre të rikonstruktura ku përfshihen:

Godinat ekzistuese: Neurologji, Psikiatri, Neurokirurgji, Akseleratori Neurokirurgji, Francez, 6-katësh, Depo Farmaceutike, Hidroklavë, Drejtori, Stacioni i pompave, Statistikë, Onkologjik, Akseleratori i Onkologjikut.

Godinat e rikonstruktura: Urgjenca e Pediatriisë, Pediatri e Specialiteteve, Infektiv, Qendra e Konsultave, Kardiokirurgji dhe Kirurgji Vaskulare.

Riparim-mirëmbajtja e furnizimit me energji të këtyre godinave përfshin:

- Kabinat elektrike 20/0.4 kV si dhe 6/0.4 kV, sipas listës bashkëngjitur, me:
Transformatorët;
Panelet e automatikës 0.4kV në kabinat elektrike me panel automatik;
Sistemet e mbrojtjes kundër mbingarkesave dhe qarqeve të shkurtra.
- Kuadrot kryesore dhe dytësore të shpërndarjes së energjisë, deri në katet -1 në hyrje të godinave;
- Kompensatorët (të pranishëm vetëm në godinën e Urgjencës së Pediatriisë, Pediatriisë së Specialiteteve dhe Infektivit);
- Panelet e komutimit (të pranishëm vetëm në godinën e 6-katëshit dhe të Neurokirurgjisë).

Për riparim-mirëmbajtjen e Sistemit të furnizimit me energji elektrike të objekteve ekzistuese dhe atyre të rikonstruktura, janë parashikuar orë pune mirëmbajtje periodike dhe pjesëfurnizim vendosje.

- Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura sipas normativave teknike dhe ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për sistemet elektrike, manualit të prodhuesit të këtyre sistemeve/pajisjeve, si dhe specifikimeve teknike të kërkuara.
- Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.
- Shërbimi i mirëmbajtjes së furnizimit me energji për këto godina përqëndrohet në:
 - **Shërbime javore:** Kontrollë të përgjithshmetë të gjitha parametrave të çdo pajisje/ sistemi elektrik, pjesë përbërës i furnizimit me energji të çdo godine, duke nisur nga kabina deri në kuadrot kryesore dhe sekondare të shpërndarjes (transformator, panelet e automatikës, sistemet e mbrojtjes, kompensator, panel komutimi, kuadrot kryesore dhe sekondare të shpërndarjes deri në katet -1 në hyrje të godinave), sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të renditura më poshtë për secilin sistem/pajisje.
 - **Shërbime mujore:** Pastrimi i përgjithshëm i të gjitha pajisjeve/sistemeve të furnizimit me energji elektrike të çdo godine, për të eliminuar grumbullimet e pluhurave në të gjitha paisjet e instaluar në to. Verifikimi i shtrënguar i morsetave dhe i pikave të paisjeve të instaluar në borde, në kuadrin kryesor dhe kuadrot e tjerë elektrik të shpërndarjes. Riparim i bravave dhe mbylljeve mekanike të dëmtuara. Shtrëngim i të gjitha lidhjeve elektrike dhe mekanike. Kontroll i konsumit të kontakteve dhe izolimit të ndërprerësve automatikë të fuqisë; sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të renditura më poshtë për secilin sistem/pajisje.
 - **Shërbime 3-mujore** apo kur ka dyshime: Matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të pajisjeve/sistemeve elektrike, përcjellesave dhe kablllove të fuqisë. Testim i sistemeve të alarmit dhe mbrojtjes ndaj mbingarkesës. Testim i ndërprerësve automatikë (automateve) për funksion On/Off, trip

manual/elektrik; sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të renditura më poshtëpër secilin sistem/pajisje.

- Pjesë furnizim-vendosje janë parashikuar ato pjesëqë mund tëdëmtohen gjatë viteve nga konsumi, sidomos për godinat ekzistuese, kryesisht kabëll, koka kablli, lëshues, përcjellës tokëzimi, automatë, vaj transformatori, bojë për lyerje të sipërfaqeve të korrozuara të transformatorit..

Shërbimet e parashikuara javore, mujore, 3 mujore, për secilin nga këto paisje /sisteme përmbliidhen si më poshtë:

Për transformatorët janë parashikuar këto shërbime:

- Kontroll i gjendjes së trupit të transformatorit për plasaritje, rrjedhje vaji (nëse është tip me vaj);
- Kontroll i lidhjeve elektrike në anën e tensionit të lartë dhe ulët për oksidim, ngrohje ose djegie;
- Kontroll i izolatorëve (për plasaritje, karbonizimi, gjurmë shkarkimi);
- Kontroll i treguesit të nivelit dhe ngjyrës së vajit (për transformatorët me vaj) dhe zëvendësimi i vajit nëse parametrat janë jashtë norme;
- Kontroll i sinjalizimeve dhe instrumenteve matës (termometra, nivel vaji, tregues lagështie);
- Kontroll i sensorëve të temperaturës, ventilimit dhe sistemeve të alarmit (transformatorët e thatë);
- Kontroll i reles së presionit (për transformatorët me vaj);
- Kontroll i pajisjeve, siguresave dhe mbrojtësve diferencialë;
- Kontroll i qarkut të tokëzimit të mbrojtjes;
- Shtrëngim i të gjitha lidhjeve elektrike dhe mekanike;
- Pastrim pluhuri, lagështie në dhomën e transformatorit, pastrim i kanaleve të ajrimit;
- Matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të pajisjeve elektrike, përcjellesave dhe kabllave të fuqisë;
- Matje e raportit të transformimit dhe krahasimi me të dhënat nominale;
- Matje e rrymës së zbrazët;
- Testim i sistemeve të alarmit dhe mbrojtjes ndaj mbingarkesës;
- Rilyerje të sipërfaqeve të korrozuara të transformatorit.

Për panelet e shpërndarjes janë parashikuar këto shërbime:

- Kontroll i gjendjes së përgjithshme të panelit (mbulesa, brava, etiketim);
- Kontroll për shenja ngrohjeje, diegie ose erë karakteristike;
- Kontroll i izolatorëve dhe mbrojtësve për plasaritje;
- Kontroll i kabllave që hyjnë/dalin (për ngjeshje, diegie ose fryrje);
- Kontroll i tokëzimit të panelit;
- Kontroll i rrymës së ngarkesës në secilën dalje;
- Kontroll dhe pastrim i shiritave të bakrit;
- Kontroll dhe shtrëngim i vidave dhe lidhjeve elektrike;
- Kontroll i gjendjes së siguresave dhe zëvendësimi i atyre të djegura;
- Kontroll i kontaktorëve dhe releve ndihmëse;
- Pastrim i pluhurit me fshesë me vakum ose ajër të kompresuar;
- Pastrim i izolatorëve me solucion të përshtatshëm nëse kanë ndotje të dukshme;
- Pastrim i kanaleve të ventilimit dhe filtrave të ajrit (aty ku ka);
- Matje e rezistencës së izolimit të qarkut;
- Matje e kontinuitetit të tokëzimit;
- Testim i funksionimit të rele mbrojtjes (mbi-rrymës, diferenciale, tensioni);
- Testim i ndërprerësve automatikë (automateve) për funksion On/Off, trip manual/elektrik;

-
- Shtim ose përmirësim i etiketimit dhe skemës elektrike në derën e panelit;
 - Riparim i bravave dhe mbylljeve mekanike të dëmtuara;
 - Zëvendësim i automatëve të djegur, kur nuk funksionon më si duhet, kur është shumë i vjetër dhe nuk garanton siguri;
 - Zëvendësim i kontaktorëve (kokave të kabllit) me kontakte të djegura.

Për kompensatorët, (të pranishëm vetëm në godinën e Urgjencës së Pediatriisë, Pediatriisë së Specialiteteve dhe Infektivit), janë parashikuar këto shërbime:

- Kontroll i përgjithshëm i panelit kompensator, për pluhur, lagështi, dëmtime mekanike;
- Kontroll i kondensatorëve për fryrje, rrjedhje vaji ose deformime;
- Kontroll i lidhjeve elektrike për oksidime ose djegie;
- Kontroll i siguresave të secilës shkallë të kondensatorit;
- Shtrëngim i vidave dhe lidhjeve të kablllove;
- Pastrim i pluhurit dhe papastërtive nga panelet dhe komponentët;
- Matje e kapacitetit të kondensatorëve (për të parë nëse kanë humbur kapacitet);
- Matje e rrymës së secilës shkallë të kompensimit gjatë funksionimit;
- Matje e faktorëve të fuqisë para dhe pas kompensimit;
- Testim i kontaktorëve dhe rezistorëve të shkarkimit;
- Testim i sistemit të mbrojtjes (rele mbrojtje, rele termike);

Për panelet e komutimit, (të pranishëm vetëm në godinën e 6-katëshit dhe të Neurokirurgjisë), janë parashikuar këto shërbime:

- Kontroll i gjendjes së përgjithshme të panelit;
- Kontroll i izolatorëve për plasaritje, djegie;
- Kontroll i kablllove që hyjnë/dalin për fryrje, ngrohje ose dëmtime;
- Kontroll i tokëzimit;
- Kontroll i mekanizmave të bravave dhe bllokimeve mekanike;
- Kontroll i mekanizmave të komandimit dhe bllokimit (levat, dorezat, motorrët elektrikë të komandimit);
- Kontroll i gjendjes së shiritave dhe mbrojtjes së tyre;
- Kontroll mekanik i hapjes dhe mbylljes së aparaturave të komutimit (shkëputësve të ngarkesës) dhe pastrim i kontakteve;
- Kontroll i konsumit të kontakteve dhe izolimit të ndërprerësve automatikë të fuqisë;
- Shtrëngim i të gjitha lidhjeve elektrike dhe mekanike;
- Pastrim i pluhurit dhe ndotjeve nga pjesët e brendshme;
- Pastrim i izolatorëve me solucion të përshtatshëm;
- Matje e rezistencës së tokëzimit;
- Matje e rezistencës së izolimit për secilin qark;
- Testim i funksionit On/Off dhe trip të ndërprerësve automatikë të fuqisë.

I/B. Sistemi i furnizimit me energji elektrike i Godinës A1 {Godina A1, Godina Teknike B (Kaldaja Qendrore)} dhe Godinës A2 .

- Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura sipas normativave teknike dhe ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për sistemet elektrike, manualit të prodhuesit të këtyre sistemeve/pajisjeve, si dhe specifikimeve teknike të kërkuara.
- Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.

Këto dy Godina kanë një skemë të ngjashme të furnizimit me energji dhe janë godinat më të mëdha për nga sipërfaqja dhe për nga numri i shërbimeve mjekësore që hospitalizojnë. Gjithashtu, në këto godina janë stacionuar shërbimet më sensitive. Në Godinën A1: Salla operacioni, Reanimacion Qendror, Skaner, Litotripti etj. Në Godinën A2: Shintigrafi, Hemodinamikë, Reanimacion Kardiologji etj.,.

Godina A1 ka një Qëndër Teknike të veçantë që është **Godina B** (Kaldaja Qendrore), ku është instaluar Kabina Elektrike 20/0.4 kV e përbërë nga 3 trasformatorë me fuqi 1000 kW.

Kabina elektrike nga ana e tensionit të mesëm 20 kV ka çelat hyrje-dalje, çelën e matjes si dhe çelat e 3 trasformatorëve 1.000 kW të thatë, nga të cilët dy janë në punë dhe një rezervë.

Futja në punë e trasformatorëve në rast avarie, mbingarkese, bëhet automatikisht.

Në Godinën B (Kaldaja Qendrore), katin zero, është e instaluar njëkohësisht skema **POWER CENTER**, ku realizohet automatika me futjen në punë të sistemit nëpërmjet automatizimit të transformatorëve dhe gjeneratorëve automatike. Në këtë panel janë 5 automatë kryesorë. Në këtë panel dalin 3 blinda LVSAB BUSBAR 4x320A, të cilët furnizojnë me energji elektrike panelin që ndodhet në katin -1 të Godinës A1, i cili është i përbërë nga automatë të rëndësishëm. Në ambjentet e katit -1 të Godinës A1 janë të instaluar disa sisteme si

Sistemi i furnizimit me energji elektrike si nga rrjeti energjitik, nga gjeneratorët automatik dhe UPS (ndriçim, priza dhe çelës).

Godina funksionale "A1" është e projektuar dhe ndërtuar si dy godina. Në nivel kati janë 8 qendrat teknike, ku janë panelet kryesore të shpërndarjes, të cilët gjithashtu janë pjesë e mirëmbajtjes.

Godina A2- Kabina Elektrike 20/0.4 kV e përbërë nga 3 trasformatorë me fuqi 1200 kW është e instaluar në një godinë teknike të veçuar në krah të katit minus 1 të Godinës A2. Kabina elektrike nga ana e tensionit të mesëm 20 kV ka çelat hyrje-dalje, çelën e matjes si dhe çelat e 3 trasformatorëve 1.200 kW të thatë. Futja në punë e trasformatorëve në rast avarie, mbingarkese, bëhet automatikisht. Po në këtë ambient teknik, në katin minus 1 është e instaluar njëkohësisht skema **POWER CENTER**, ku realizohet automatika me futjen në punë të sistemit, lëshues - transformatorë dhe gjeneratorë automatikë.

Nga paneli në katin minus 1 të ambientit teknik të godinës A2, furnizohet me energji elektrike paneli që ndodhet në katin -2 brënda në Godinën A2, i cili është i përbërë nga automatë të rëndësishëm. Këto panele (në katin -2) furnizojnë të gjithë sistemin elektrik të godinës dhe janë pjesë e mirëmbajtjes.

➤ Shërbimi i mirëmbajtjes së furnizimit me energji për këto godina përqëndrohet në:

- **Shërbime javore:** Kontrollë, Inspektive

- **Shërbime mujore:** Përsëritja e veprimeve (javore) dhe gjithashtu:

Verifikimi i shtrënguar i morsetave dhe të pikave të paisjeve të instaluar në borde, në kuadrin kryesor dhe kuadrot e tjerë elektrik të shpërndarjes.

Pastrimi i lokalit teknik, kabinës, paisjeve të kuadrit, kuadrot kryesore, kuadrove

dytësore, për të eliminuar grumbullimet e pluhurave në të gjitha paisjet e instaluar në to, duke

Përdorur fshesën me korent, një kujdes i veçantë duhet të ushtrohet në pastrimin e grilave të ventilimit, të instaluar si në makineri dhe në faqet e saj.

- **Shërbime 3-mujore** apo kur ka dyshime: Përsëritja e veprimeve, javore dhe mujore, si dhe:

Kabina e transformimit me transformator të thatë: Kontrolli si në lidhjen "B1"

Prova e ndërhyrjes së paisjeve çkycëse të: Panelit të TU; Çkycja e kabinës së transformatorit.

Ngarkesat e lidhura nga gjeneratori me funksionim të njëkohshëm (prova e c'kycjes automatike edhe manuale).

Verifikimi i funksionimit të llampës së sinjalizimit të qarqeve c'kycëse.

-
- Pjesët furnizim-vendosje janë parashikuar ato pjesë që mund të dëmtohen gjatë viteve nga konsumi, kryesisht kabëll, koka kablli, lëshues, përcjellës tokëzimi, automatë, llampa neoni 18w, 36w, 58w; drozela e startera, për ambientet në qendrat teknike të transformimit A1, A2.

Shërbimet e parashikuara në preventiv, për secilin nga këto paisje /sisteme përmbledhen si më poshtë:

I B/1) Kontrolle dhe shërbimenë kabinat e transformimit (Godina A1 dhe Godina A2):

- Kontroll i gjendjes së trupit të transformatorit për plasaritje;
- Kontroll i lidhjeve elektrike në anën e tensionit të lartë dhe tëulët për oksidim, ngrohje ose djegie;
- Kontroll i izolatorëve (për plasaritje, karbonizimi, gjurmë shkarkimi);
- Kontroll i sensorëve të temperaturës, ventilimit dhe sistemeve të alarmit
- Kontroll i temperaturës së funksionimit të transformatorit;
- Kontroll i funksionimit të grupit të ndërhyrjes në qarqet ndihmës;
- Kontrolli qarqeve ndihmës;
- Kontrolli funksionimit të nxjerrjes së ajrit dhe termostatit përkatës në ambjentin e komandimit;
- Kontroll i gjendjes të dorezave izoluese dhe tapeteve;
- Kontroll dhe shtrëngim i morsetave dhe të pikave të paisjeve të instaluar në borde, në kuadrin kryesor dhe kuadrot e tjerë elektrik të shpërndarjes;
- Pastrimi komplet i lokalit teknik, kabinës, paisjeve të kuadrit, kuadrot kryesore, kuadrove dytësore, për të eliminuar grumbullimet e pluhurave në të gjitha paisjet e instaluar në to;
- Pastrimi i përgjithshëm i grilave të shkëmbimit të ajrit;
- Prova e ndërhyrjes së paisjeve c'kycëse të: Panelit të TU dhe kycja e kabinës së transformatorit (prova e c'kycjes automatike edhe manuale);
- Verifikimi i funksionimit të llampës së sinjalizimit të qarqeve c'kycëse;
- Matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të paisjeve elektrike, përcjellesave dhe kabllave të fuqisë.

I B/2 Kontrolle dhe shërbimenë Power Center (Godinën Teknike B për A1 dhe ambienti teknik nëminus 1 për A2)

- Prova kampion i automatëve diferencial nëpërmjet pulsanit TEST;
- Prova kampion e automatëve magneto-termik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike edhe të lidhjes së shkurtër;
- Kontrolli termik i automatëve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distançe të tyre;
- Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave përkatës; Prova e logjikës së funksionimit të POWERCENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në llogjikën e funksionimit;
- Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWERCENTER-it;
- Kontrolli i gjendjes të shkarkuesve të mbitensionit;
- Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës;
- Kontroll dhe matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të paisjeve elektrike, përcjellesave dhe kabllave të fuqisë;
- Pastrim i pluhurit me fshesë me vakum ose ajër të kompresuar;

I B/3Kontroll dhe shërbime në blindosbarrën kryesore të furnizimit të objektit A1

- Kontroll vizual i gjithë linjës së blindosbarrës kryesore të furnizimit për dëmtime mekanike apo korrozive;
- Matja në mënyrë periodike e izolacionit nëpërmjet instrumentit përkatës me tension jo më shumë se 2000V;
 - Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension pa ngarkesë;
 - Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension me ngarkesë të plotë.

I B/4 Kontroll dhe shërbime në Power Center (kati minus 1 i Godinës A1 dhe kati minus 2 i Godinës A2).

- Prova kampion e automateve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST; Prova kampion e automatëve magneto-termik, nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër.
- Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave përkatës,
- Prova e llogjikës së funksionimit të POWERCENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në llogjikën e funksionimit,
- Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWERCENTER-it,
- Kontrolli i gjendjes të shkarkuesve të mbitensionit,
- Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,
- Kontroll dhe matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të pajisjeve elektrike, përcjellesave dhe kabllave të fuqisë;
- Pastrim i pluhurit me fshesë me vakum ose ajër të kompresuar;

I B/5 Kontrolli i kuadrove kryesore të shpërndarjes të Godinës A1 dhe Godinës A2 dhe i kuadrove elektrik në nivel kati vetëm të godinës A1.

- Prova kampion e automatëve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,
- Prova kampion e automatëve magnetotermik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër,
- Kontrolli termik i automateve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distancë të tyre,
- Prova me instrumentat elektronik të matjes, për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave përkatës;
- Kontrolli i gjendjes të shkarkuesve të mbitensionit;
- Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës;
- Verifikimi i tokëzimit;
- Pastrim i pluhurit me fshesë me vakum ose ajër të kompresuar;
- Zëvendësim i automatëve të djegur, kur nuk funksionon më si duhet, kur është shumë i vjetër dhe nuk garanton siguri;
- Zëvendësim i kontaktorëve (kokave të kabllit) me kontakte të djegura.

II. GJENERATORËT

Motogjeneratori siguron energji rezervë në rast të një ndërprerjeje të energjisë nga rrjeti. Motogjeneratori në spital është garancia e vazhdimësisë së shërbimit shëndetësor dhe shpëtimit të jetës. Mirëmbajtja e tij e rregullt nuk është thjesht masë teknike, por edhe detyrim ligjor, profesional dhe etik, sepse nga funksionimi i tij varet siguria e pacientëve dhe puna e stafit mjekësor. Gjeneratori mund të qëndrojë me muaj pa u përdorur realisht, por vetëm përmes mirëmbajtjes periodike sigurohet që ai do të ndizet dhe do

të mbajë ngarkesën kur nevojitet. Mirëmbajtja është po aq e rëndësishme sa vetë instalimi i gjeneratorit, pasi një gjenerator i pa mirëmbajtur mund të dështojë pikërisht në momentin më kritik.

- Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e motogjeneratorëve, sipas listës së inventarit bashkëngjitur, duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura sipas normativave teknike dhe ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për sistemet elektrike në tërësi dhe motogjeneratorët në veçanti, si dhe bazuar në tipin/modelin/vitin e vënies në punë dhe manualin përkatës të prodhuesit.
- Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.

II/ASHërbime mirëmbajtje për të gjithë motogjeneratorët, përqendrohet në:

- **Shërbime javore:** Kontrolle, Inspektive, test pa ngarkesë;
 - **Shërbime mujore:** Shërbimi javor + Test me ngarkesë, ATS, pastrim i jashtëm;
 - Shërbime 3 mujore:** Shërbimi mujor + Kontroll radiator, tubacione, shkarkim, tokëzim, kontroll injektore; prova e ndërhyrjes në automatikë me anë të simulimit të mungesës të rrjetit
 - Shërbime 1 vjeçare:** Ndërrim vaji+filtrat, testim i plotë në ngarkesë, kalibrim instrumentesh, kontroll i valvulave dhe guzhinetave.
- Orët e punës javore, mujore, tremujore dhe 1 vjeçare, të parashikuara në preventiv, për Kontrolle dhe shërbime mirëmbajtje për të gjithë gjeneratorët, përmbledhen si më poshtë:

II A/1 Shërbime mirëmbajtje:

- Kontroll vizual i gjendjes së përgjithshme të motogjeneratorit;
- Kontroll i jashtëm i gjendjes së motorit;
- Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant;
- Kontroll i injektorëve;
- Kontroll i gjendjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes;
- Kontroll kuzhinetash të alternatorit dhe lubrifikim nëse nevojitet;
- Kontroll dhe rregullim i valvulave të motorit;
- Kontroll i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik;
- Kontroll vizual i serbatorit për rrjedhje;
- Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkese nëpër fazë;
- Kontroll i lëngut ftohës në radiator;
- Kontroll i baterisë terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj;
- Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale;
- Pastrim i jashtëm i gjeneratorit;
- Prova e ndërhyrjes në automatikë me anë të simulimit të mungesës të rrjetit OSHEE;
- Vënia në punë në mënyrë periodike, për të kontrolluar të gjithëparametrat e nevojshëm të gjeneratorit.

II A/2Orë pune Riparimi: Riparime të qarqeve elektrike dhe të komandimit; Riparim i pompës së naftës, gjeneratorit e dinamos; Eliminim rrjedhjesh.

II/B. Zëra furnizim-vendosje të përgjithshme

Në zërat furnizim vendosje të përgjithshme, për të gjithë motogjeneratorët, janë parashikuar pjesë këmbimi të cilat nga konsumimi gjatë viteve kanë më shumë propabilitet të defektohen dhe të krijojnë avari në të gjithë sistemin, si bateri, kapikorda, panel komandimi (për dy tipe fuqish gjeneratorësh), skedë

komandimi (për dy tipe fuqish gjeneratorësh), sensor vaji, sensor temperature, kontaktorë të vegjël, kontaktorë ATS të fuqisë, led sinjalizues, MCB dhe MCCB për panel.

II/C. Zëra furnizim-vendosjesipas tipit të Motogjeneratorit

Preventivi i zërave furnizim-vendosje për motogjeneratorët është hartuar i ndarë në kapituj për secilin gjenerator, duke qenë se ato janë të modeleve, fuqive, parametrave teknike dhe vit prodhimi të ndryshëm, panvarësisht se kryejnë funksione të njëjta. Për këtë arsye, pjesët e këmbimit për furnizim-vendosje si filtër vaji, filtër naftë, filtër ajri, vaj lubrifikant, duhet të jenë në përputhje apo të përshtatshme me specifikat teknike të secilit gjenerator, po ashtu edhe çmimi i ofertuar.

Për secilin motogjenerator janë parashikuar:

- Ndërrimi i filtrave të vajit, naftës dhe ajrit;

Frekuenca e ndërrimit të filtrave të motogjeneratorëve varet nga orët e punës në vit, cilësia e karburantit, ajrit dhe kushteve të punës, si dhe udhëzimeve të prodhuesit.

Ndërrimi i filtrave të vajit, naftës dhe ajrit është parashikuar 1 herë/vit për çdo motogjenerator, pasi edhe nëse gjeneratori nuk punon shumë (kryesisht gjatë testeve javore dhe në raste avarish):

- Filtri i vajit grumbullon papastërti sa herë që motorri punon dhe sipas standarteve europiane ndërrimi 1 herë/vit është minimumi i detyrueshëm;
- Edhe nëse motorri nuk punon shumë, karburanti në depozitë mund të mbledhë ujë ose papastërti, ndaj rekomandohet ndërrimi 1 herë/vit i filtrit të naftës,
- Edhe nëse nuk konsumohet shumë nga rastet apo testet, filtri i ajrit, si rezultat i pluhurit që mbidhet në ambient, rekomandohet ndërrim 1 herë/vit. Nëse nga kontrollet filtri rezulton i pastër, mund të përdoret edhe pak më gjatë.

- Ndërrimi i vajit;

Vaji plakët nga oksidimi, kondensimi i lagështisë dhe acidet që formohen gjatë ndezjeve të shkurtra në testet periodike javore. Ndërrimi i vajit 1 herë/vit është standart i detyrueshëm, pasi faktorët e mësipërm dëmtojnë motorrin nëse vaji qëndron më gjatë se 1 vit. Vaji dhe filtri i vajit ndërrohen njëkohësisht.

Për Motogjeneratorë Godinës A1 (Tip "C.T.M GARIBOLDI", 1.000 kVA, 2copë) dhe Motogjeneratorët e Godinës A2 (Tip "FMT Generator", 1265 kVA, 2copë), duke qenë se kanë një skemë ndryshe nga gjeneratorët e tjerë dhe mbulojnë shërbime shumë sensitive (salla operacioni, reanimacione, imazheri, skaner..etj), për tu siguruar që i gjithë kuadri i automatikës funksionon brënda parametrave teknike të prodhuesit dhe standarteve elektrike, me qëllim që të garantohet funksionalitet 24orë/24 dhe të parandalohen avaritë e mundshme, janë parashikuar zërat "Mirëmbajtje-Riparim i panelit të automatikës", i cili përfshin:

- *Kontrolli i diagnostikimit:*

Kontroll i "mains fail", për tu siguruar që paneli merr sinjal nga rrjeti

Matje e tensioneve të fazave dhe sinjaleve hyrëse

Verifikim i sinjalit start/stop që del nga paneli drejt motorrit

Kontroll i moduleve elektronike (controller, relays, kontaktorë)

Lexim i alarmeve të defekteve në ekran dhe/ose përmes software nëse shihet e nevojshme

- *Testim i llogjikës së punës automatike:*

Kontroll nëse funksioni "Auto Main Failure" është aktivizuar

Verifiki i kohëve të vonësës (delay start, delay stop, return to mains)

Prova e ndërhyrjes në automatikë me anë të simulimit të ndërprerjes së energjisë nga rrjeti

Kontroll nëse konektorët e rrjetit dhe gjeneratorit aktivizohen saktë dhe me interlock mekanik/elektrik të paprekur

Simulimi i lidhjes së dy gjeneratorëve në paralel për të rritur shkallën e sigurisë së impiantit

-Kontroll dhe zëvendësim i komponentëve elektrikë, në varësi të problemit, riparimi mund të përfshijë:

Zëvendësim releje komandimi ose rele starti (që aktivizon motorin)
Riparim/ndërrim kontaktorësh që nuk kalojnë ngarkesën
Ndërrim butonash, Led sinjalizuesish, siguresash ose MCB të djegura
Pastrim i kontakteve të karbonizuara dhe kontroll i lidhjeve të lirshme
Kontroll i ushqimit të tensionit ndihmës që furnizon kontrolluesin

- Kontroll dhe rikonfigurim i kontrolluesit::

Kontroll nëse modaliteti Auto është aktiv në programim
Rikonfigurim i parametrave
Përditësim firmware ore rivendosje në konfigurimin original të fabrikës

- Testim i funksionimit pas riparimit:

Testim i plotë i sistemit për kalim automatik
Testim i sistemit të alarmit dhe marrjes së sinjaleve nga sensorët e motorrit
Kontroll i baterive të komandës nëse mbajnë ngarkesë

Në fund të procesit të mirëmbajtjes-riparimit të këtyre gjeneratorëve (Godinës A1 dhe A2), kërkohet që Operatori Ekonomik të përgatisë një raport teknik i cili të përfshijë: Përshkrimin e gjendjes teknike fillestare dhe defekteve që mund të konstatohen, veprimet e kryera, pjesët e ndërruara (nëse janë ndërruar), parametrat e rikonfiguruar, testi final i kalimit automatik (mains-fail test), si dhe nëse është e nevojshme ndërhyrje të tjera që mund të rekomandohen për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e mëtejshëm të këtyre sistemeve.

III. UPS

UPS objekt i kësaj procedure mirëmbajtje, shërbejnë vetëm për linjat kritike të prizave të kuqe në pavione, dhoma pacientësh, dhoma diagnostikimi, terapie, salla operacioni ose reanimacioni ku lidhen pajisje bazë pranë pacientit, si monitorë, pompa infuzioni, aspiratorë portativë., etj. Ato sigurojnë energji të pandërprerë për këto linja kritike, gjatë sekondave të para të ndërprerjes së energjisë deri sa të marrë ngarkesën gjeneratori i godinës. Mirëmbajtja e UPS është thelbësore për të garantuar funksionimin e tij në çdo moment kritik, duke siguruar që linjat kritike të mos mbeten asnjëherë pa energji dhe mos të cënohet jeta e pacientit. Një mirëmbajtje korrekte parandalon defektet përmes kontrollit të lidhjeve, pastrimit dhe testimit periodik, siguron jetëgjatësinë e baterive (elementit më kritik të sistemit) si dhe përmbush standartet ligjore dhe spitalore të sigurisë elektrike sipas normativave shëndetësore ndërkombëtare (IEC/EN, HTM etj.,)

Plani i mirëmbajtjes së UPS kombinohet gjithmonë me teste të gjeneratorit, për të garantuar zinxhirin e sigurisë: rrjeti→UPS→gjenerator→linjat kritike.

- Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e UPS, sipas listës së inventarit bashkëngjitur, duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura sipas normativave teknike dhe ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për sistemet elektrike në tërësi dhe UPS në veçanti, si dhe bazuar në tipin/modelin/vitin e vënies në punë dhe manualin përkatës të prodhuesit.
- Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.

Periodiciteti i mirëmbajtjes së UPS-ve është përcaktuar në përputhje me udhëzimet e prodhuesëve të këtyre UPS, si dhe me standartet ndërkombëtare për mirëmbajtjen e UPS-ve dhe baterive.

Për mirëmbajtjen e pajisjeve UPSjanë parashikuar:

Kontrolle mujore

- Kontroll vizual i panelit të UPS-it për alarme ose mesazhe gabimi në ekran
- Kontroll gjendje baterish për alarme “Battery Fault / Replace Battery”
- Kontroll i temperatures së ambienti (duhet 20–25 °C, pa lagështi)
- Kontroll ventilatorësh nëse punojnë normalisht, pa zhurma ose vibrime
- Kontroll për prani pluhuri ose pengesa në hyrje/dalje ajri
- Kontroll i ngarkesës aktuale $\leq 80\%$ e kapacitetit total

Kontrolle çdo 6 muaj

- Pastrim i filtrave dhe ventilatorëve me ajër të kompresuar ose zëvendësim nëse janë të dëmtuar
- Kontroll lidhjesh elektrike dhe shtrëngime të terminaleve input/output, bypass, tokëzim
- Kontroll tensioni DC bus (duhet të jetë në intervalin $\pm 2\%$ të nominales)
- Testim manual i kalimit në bateri dhe rikthimit, testim me ngarkesë, verifikim që kalimi është i butë
- Kontroll i funksionimit të by-passit statik dhe alarmeve nëse ka
- Kontroll alarmesh / sinjalizimesh, testim me panelin e jashtëm

Kontrolle vjetore

- Testim i plotë funksional i UPS-it me ngarkesë reale ose fiktive, verifikim i performancës
- Kontroll i gjendjes së baterive, duke matur impedancën individuale të çdo blloku
- Kontroll kondensatorësh DC/AC (vlerat duhet të jenë brenda $\pm 10\%$ të nominales)
- Testim i EPO (Emergency Power Off) për tu siguruar që funksionon dhe rivendoset pa defekt
- Përditësim firmware (kur ka)
- Kontroll vizual i moduleve të fuqisë, verifikim për shenja oksidimi, pluhuri, nxehtësie
- Përditësim dokumentacioni teknik, përfshi matje, ngarkesë, alarmet, version firmware

Kontroll dyvjeçar

- Testim i plotë i performancës, me ngarkesë 80–100 %, testim 4 orë minimum
- Kontroll dhe zëvendësim i filtrave të ajrit, zëvendësim nëse janë të plasaritur ose shumë të ndotur
- Kontroll i ventilatorëve, duke matur shpejtësinë dhe zëvendësime nëse zhurmojnë apo janë difektuar
- Kontroll i kabllave të fuqisë dhe tokëzimit
- Testim baterish nën ngarkesë reale duke vlerësuar autonominë efektive (koha e furnizimit)
- Kontroll i kartave elektronike, pastrim me ajër të thatë dhe inspektim për djegie / oksidim
- Përgatitje e raportit teknik për 24 muaj, përfshi të gjitha matjet dhe rekomandimet për vitet e ardhshme

Pjesët e këmbimit janë parashikuar në përputhje me normativat e standardet ndërkombëtare për mirëmbajtjen e UPS-ve, vitit të vënies në punë të tyre (vjetërsisë), manualit të prodhuesit si dhe gjendjes faktike të tyre.

Janë parashikuar ndërrim filtra ajri, ventilatorë, siguresa dhe kontaktorë të cilët mund të digjen me kalimin e viteve, bateri (12V, 9Ah–12Ah sipas konfigurimit) pasi nga testet mund të konstatohen njësi të cilat kanë reduktuar efikasitetin ose kanë tejkaluar jetëgjatësinë e rekomanduar nga prodhuesi si dhe panel komandimi për dy tip fuqish UPS, në rast se ndonjërit ndodh t'i digjet paneli.

LISTA KABINA ELEKTRIKE 20/04 kV dhe 6/0.4 kV (OBJEKT I MIRËMBAJTJES)									
Nr	Emërtimi	Viti i instalimit	Vendndodhja	Nr. transformatore ve	Kapaciteti transformatorit kVA	Kompensator	Panel Komutimi	Tipi i izolimit	Konsumatorët Kryesore të Furnizuar
1	Kabina elektrike 20 kV	2002	Pavionet e Ulëta	1	400			Vaj	Administrata, Stacioni pompave, Statistika.
2	Kabina elektrike 20 kV	2024	Kardiokirurgji	1	630			Thate	Kardiokirurgji dhe Kirurgji Vaskulare
3	Kabina elektrike 20 kV	2004	Onkologjik dhe Akseleratori Onkologjik	2	400			Vaj	Onkologjik dhe Akseleratori Onkologjikut (Radioterapi)
4	Kabina elektrike 20 kV	2022	Infektiv	2	1250	2cope 350kVAr, shkalle kompensimi (50+4x75 kVAr)		Thate	Infektiv
5	Kabina elektrike 20 kV	2004	6-kateshi	1	630		1	Vaj	Spitali 6- katesh
6	Kabina elektrike 20 kV	2021	Urgjenca e Pediatrise	2	630	2 cope 200kVAr		Thatë	Godina e urgjences se Pediatrise
7	Kabina elektrike 20 kV	2024	Pediatri e Specialiteteve	1	800	1		Thatë	Godina e Pediatrise se Specialiteteve dhe Godinen e Pediatrise se Pergjithshme dhe Infektive
8	Kabina elektrike 20 kV	2005	Francezi	2	400			Vaj	Godina e Francezit
9	Kabina elektrike 20 kV	2004	Neurologji/Psikiatri/Akseletarori Neurokirurgji	2	630			Thatë	Neurologji/ Psikiatri/ Akseleratori Neurokirurgjise
10	Kabina elektrike 20 kV	2019	Depo Farmaceutike	1	400			Thatë	Depo Farmaceutike, Hidroklava
11	Kabina elektrike 20 kV	2012	Neurokirurgjia	1	630		1	Thatë	Neurokirurgji
12	Kabina elektrike 20 kV	2009	Qendra Teknike "Godina B" dhe kati minus 1 "Godina A1"	3	1000			Thatë	E gjithë godina A1
13	Kabina elektrike 20 kV	2023	Kati minus 1 dhe kati minus 2 "Godina A2"	3	1200			Thatë	E gjithë godina A2
14	Kabina elektrike 6 Kv	1980	Spitali Nr.1- 6 kateshi	3	320,400,560			VAJ	6-katesh
15	Kabina elektrike 6 kV	2007	Psikiatri	1	400			VAJ	Ndertesa Neurologjise,Psikiatrie, Rehabilitimi i te Rriturve dhe Fëmijeve,
16	Kabina elektrike 6 kV	1980	Pavionet e Ulëta	1	320			VAJ	Administrata, Stacioni Pompave,Statistika

LISTA MOTOGENERATORËVE (OBJEKT I MIRËMBAJTJES)																
	Godinat Spitalore															
Parametrat teknike	A2	A1	Depo Farmaceutike	Francezi	Urgjenca e Pediatrise	Pediatrit e Specialitetete	Infektiv	Onkologjik (salla/rea)	Akseleratori Onkologjik	Neurokirurgji	Akseleratori Neurokirurgji	Angiografi Neurologji	Kardiokirurgji i & Kirurgji Vaskulare	6 Kateshi		Sasia Totale
Nr. gjeneratoreve ne cdo objekt	2	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	17
Prodhuesi	FMT Generator	GARIBOLDI Compagnia Tecnica Motori	FMT Generator	PRAMAL	FMT Generator	KZ Power	FMT Generator	Bruno	FMT group Genset	Teksan	FMT Generator	Kurkcuoglu jenerator	FMT Generator	Mecc Alte	Mosa	
ID/Nr. serial gjeneratorit	GEN10-JUN21	6830/1	GEN35-2019DEC18	SC201TWAY02	GEN01-2020DEC04	KZ2308087	GEN0344-JUN22				ED10A323392	5KJ1816	GEN03207-MAY25	17866188	3254699010	
Modeli gjeneratorit	FF1265F	MT1000A	FGR178M	GSW200	FGS50F	KZSD-G600	FSC760W-C5161	GQ70P	150220R1402 N439	TJ159SD5E	FDD275MC	KJR200	GE400P	ECO 38-11LN/4	GE110SX-EAS	
Modeli Motorrit	R4-16V30L-DS2	18V2000	KX-6L-DN	VOLVO TADT22GE	KX7-6L-DN	SD27G700TLD	DC1607BA	T4236		SC8D200D		1088031	KXD-6L			
Modeli i Alternatorit	FA1265XP4	HC6J	MXB225LC4	ST AMFORD UCI 274M	FA550XP4	GNT-500	AG10-315M120AI			MWL34540 28B1	ECO38-11LN/4		PQ450			
Vit prodhimi	Qershor 2021	2008	Dhjetor 2019	2004	Dhjetor 2020	Maj 2023	Maj 2022	1998	2015	2011	2013	Dhjetor 2011	2025	gusht 2014	gusht 2014	
ESP (kVA)	1265	1100	178	220	560	600	760	66	200	159	275	200	400	300	110	
PRP (kVA)	1150	1000	160.2	206.31	509.1	557	709	60	160		250	180	364	250	36.5	
Faktori fuqise	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	
Shpejtesia e motorrit (rpm)	1500		1500	1500	1500	1500	1500	1500			1500	1500	1500	1500/1800	1500	
Tension nominal	400	400	400	400	400	400	400	400			400	400	400	400	400	
Nr. Fazave	3	3	3	3	3	3	3	3			3	3	3	3	3	
Sistemi Elektrik (VDC)	24		12		24		12						24			
Tipi gjeneratorit	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	Canopy	
Lloji i punes/ tip panel kontrolli	Auto/DSE7320	Auto	Auto/GEN-A	Auto	Auto/ GENA	Auto	Auto/GEN4	Auto	Auto	Auto	Auto	Auto	Auto/DEIF420			
Dimensioni (cm)	230x750x250		120x130x185		170x420x230	190x450x255	170x420x230		112x305x160		408x137x215		130x380x185			
Kapaciteti i rezervuarit (lt)	2000		450		1000		900		260		450		530			

	LISTA UPS (OBJEKT I MIRËMBAJTJES)						
Nr.	Vendndodhja	Sasia (cope)	Prodhuesi	Modeli	Viti i venies ne pune	Kapaciteti	Fazat
1	Godina A2	2	DKC EUROPE S.R.L	DKC EXTRATT160A10	2023	160 kVa / 160 kW	Trefazor+Neutral (3F+N)
2	Godina A1	2	SCHNEIDER	GALAXY 5500/ INT PARAL/ G55TUPSM120H	2012	120 kVa /108 kW	Trefazor dhe Toke (3W+PE)
		1	SCHNEIDER	GALAXY 5500/ INT PARAL/ G55TUPSM60H	2012	60 kVa /54 kW	Trefazor dhe Toke (3W+PE)
3	Urgjenca e Pediatrie	2	BORRI	INGENIO PLUS	2021	125 kVA/125kW	Trefazor+Neutral (3F+N)
4	Pediatri e Specialiteteve	1	BORRI	INGENIO MAX	2024	200 kVA/200 kW	Trefazor+Neutral (3F+N)
5	Infektiv	2	BORRI	INGENIO PLUS	2022	40 kVA/40kW	Trefazor+Neutral (3F+N)
6	Kardiokirurgji	1	SCHNEIDER	EASY UPS 3M 3:3 , E3MUPS120KH	2025	120kVA/120kW	Trefazor me Neutral dhe Toke (3W+N+PE)
		1	SCHNEIDER	EASY UPS 3M 3:3 , E3MUPS60KH		60kVA/60kW	Trefazor me Neutral dhe Toke (3W+N+PE)
Totali UPS (cope)		12					

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtje impiantesh elektrike për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme
I	SISTEMI I FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE		
I/A.	Sistemi i furnizimit me energji elektrike i objekteve ekzistuese dhe të rikonstruara		
1	Kontroll i të gjitha parametrave, Shërbime mirëmbajtje dhe Riparime në të gjithë pajisjet elektrike të furnizimit me energji të çdo godine, duke nisur nga kabina deri në kuadrot kryesore të shpërndarjes (transformator, panelet e shpërndarjes, sistemet e mbrojtjes, kompensator, panel komutimi, kuadrot kryesore të shpërndarjes), sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike për secilën nga këto paisje /sisteme.	Orë pune	1,100
2	Matje e rezistencës së tokëzimit dhe izolacionit të pajisjeve elektrike, përcjellesave dhe kabllave të fuqisë, sipas kërkesave dhe specifikimeve , sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike për secilën nga këto paisje / sisteme.	Orë pune	456
3	Testim i pajisjeve elektrike, verifikim i paneleve të automatikës sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike për secilën nga këto paisje /sisteme.	Orë pune	180
4	F.V kabëll 0.4kV 4x35mm ²	ml	140
5	F.V kabëll 0.4kV 4x25mm ²	ml	140
6	F.V kabëll 0.4kV 4x16mm ²	ml	140
7	F.V kabëll 0.4kV 4x10mm ²	ml	110
8	F.V kabëll 0.4kV 4x6mm ²	ml	110
9	F.V koka kablli 0.4kV/35mm ²	copë	16
10	F.V koka kablli 0.4kV/25mm ²	copë	16
11	F.V koka kablli 0.4kV/16mm ²	copë	16
12	F.V koka kablli 0.4kV/10mm ²	copë	20
13	F.V koka kablli 0.4kV/6mm ²	copë	14
14	F.V çelës me 2 pozicione 400 A	copë	4
15	F.V leshues elektro-magnetik 4 polar, 160A me bllokim mekanik	copë	4

16	F.V leshues elektro-magnetik 4 polar, 250A me bllokim mekanik	copë	6
17	F.V leshues elektro-magnetik 4 polar, 630A me bllokim mekanik	copë	4
18	F.V Multimeter per panel automatik	copë	4
19	F.V Percjelles tokezimi bakri, Cu, S=35mm2 i zhveshur	ml	100
20	F.V elektroda tokëzimi të gatshme	copë	30
21	F.V automat 4 polar 380 V/660 A	copë	16
22	F.V automat 4 polar 380 V/250 A	copë	16
23	F.V automat 4 polar 380 V/160 A	copë	16
24	F.V automat termo-elektro magnetik 4P; 380V; 100A	copë	16
25	F.V automat termo-elektro magnetik 4P; 380V; 40A	copë	12
26	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 2P C 10A	copë	16
27	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 2P C 16A	copë	16
28	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 4P C 20A	copë	16
29	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 4P C 25A	copë	16
30	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 4P C 32A	copë	16
31	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 4P C 40A	copë	16
32	F.V. Automat magneto-termik MCB 6000A 4P C 50A	copë	16
33	F.V. Automat magneto-termik MCB 10000A 4P C 80A	copë	16
34	F.V. Automat magneto-termik MCB 10000A 4P C 125A	copë	16
35	F.V vaj transformatori	litra	120
I/B	Sistemi i furnizimit me energji elektrike i Godinës A1 {Godina A1 dhe Godina Teknike B (Kaldaja Qendrore)} dhe Godinës A2 .		
1	Kontrolle dhe shërbime në kabinat e transformimit (Godina A1 dhe Godina A2), sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike në pikën I B/1.	Orë pune	778
2	Kontrolle dhe shërbime në Power Centera (Godinën Teknike B për A1 dhe ambientin teknik në minus 1 për A2), sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike në pikën I B/2.	Orë pune	468
3	Kontroll dhe shërbime në blindosbarren kryesore të furnizimit të objektit A1, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike në pikën I B/3	Orë pune	516
4	Kontroll dhe shërbime në POWER CENTER (kati minus 1 i Godinës A1 dhe kati minus 2 i Godinës A2), sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike në pikën I B/4	Orë pune	468
5	Kontrolli i kuadrove kryesore të shpërndarjes të Godinës A1 dhe Godinës A2 dhe i kuadrove elektrik në nivel kati vetëm të godinës A1, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike në pikën I B/5.	Orë pune	752
6	F.V automat 1P+N 6A C 6KA DPN	Copë	12
7	F.V automat 1P+N 10A C 6KA DPN	Copë	12
8	F.V automat 1P+N 16A C 6KA DPN	Copë	12
9	F.V automat 1P+N 20A C 6KA DPN	Copë	12
10	F.V automat 1P+N 32A C 6KA DPN	Copë	12
11	F.V automat 1P+N 40A C 6KA DPN	Copë	10

12	F.V automat 3P+N 10A C 6KA DPN	Copë	12
13	F.V automat 3P+N 16A C 6KA DPN	Copë	12
14	F.V automat 3P+N 40A C 6KA DPN	Copë	10
15	F.V automat 3P+N 32A C 6KA DPN	Copë	12
16	F.V automat DC 2P 16A C 10kA C60H	Copë	12
17	F.V automat DC 2P 20A C 10kA C60H	Copë	12
18	F.V automat DC 2P 40A C 10kA C60H	Copë	10
19	F.V automat DC 2P 63A C 10 kA C60H	Copë	10
20	F.V automat 4P 10A D 10 kA C60H	Copë	12
21	F.V automat 4P 20A D 10 kA C60H	Copë	12
22	F.V automat 4P 32A D 10 kA C60H	Copë	12
23	F.V automat 4P 40A D 10 kA C60H	Copë	10
24	F.V automat 4P 80A D 10 kA C120	Copë	10
25	F.V automat 4P 100A D 10 kA C120	Copë	10
26	F.V automat 4P 125A D 10 kA C120	Copë	10
27	F.V automat 4P 250A D 10 kA C120	Copë	15
28	F.V automat 4P 400A D 10 kA C120	Copë	10
29	F.V automat SACE E3N, IU3200A, UE690V, ICW65kA*1s (M48-60V)	Copë	4
30	F.V celës drite vimar planar	Copë	12
31	F.V deviat vimar plana	Copë	12
32	F.V buton për komandimin e ndricimit	Copë	12
33	F.V prize bivalente vimar plana	Copë	14
34	F.V prize shuko 16A vimar planar	Copë	14
35	F.V suport 3 module	Copë	12
36	F.V suport 4 module	Copë	14
37	F.V pllake plastike 3 module	Copë	12
38	F.V llampë neoni 18W	Copë	120
39	F.V llampë neoni 36W	Copë	120
40	F.V llampë neoni 58W	Copë	120
41	F.V drozel	Copë	40
42	F.V starter	Copë	40
II	MOTOGJENERATORËT		
II/ A	Shërbime mirëmbajtje periodike për të gjithë motogjeneratorët		
1	Kontrolle dhe shërbime mirëmbajtje sipas specifikimeve dhe kërkesave teknike, në pikën II A/1.	Orë pune	2,046
2	Riparime të: qarqeve elektrike dhe të komandimit, riparim i pompës së naftës, gjeneratorit e dinamos; eliminim rrjedhjesh, sipas pikës II A/2 të specifikimeve teknike.	Orë pune	200
II/ B	Zëra furnizim-vendosje të përgjithshme		
1	F.V bateri 165 A 12 V	Copë	4
2	F.V bateri 100 A 12 V	Copë	16
3	F.V bateri 65-85 A 12 V	Copë	8
4	F.V kabell baterie	ml	30
5	F.V kapikorda	Copë	70

6	F.V Panel komandimi për motogjenerator 400 kVA	Copë	1
7	F.V Panel komandimi për motogjenerator 760 kVA	Copë	1
8	F.V Skedë komandimi për motogjenerator 400 kVA	Copë	2
9	F.V Skedë komandimi për motogjenerator 760 kVA	Copë	2
10	F.V Sensorë vaji	Copë	16
11	F.V Sensorë temperature	Copë	16
12	F.V Kontaktorë të vegjël	Copë	16
13	F.V Kontaktorë ATS transferim të fuqisë	Copë	4
14	F.V Led sinjalizues 22 mm	Copë	20
15	F.V MCB për panel, sipas tipit	Copë	20
16	F.V MCCB sipas tipit të panelit	Copë	2
II/C	Zëra furnizim-vendosje sipas tipit të Motogjeneratorit		
II C/1	Motogjenerator Tip "FMT Generator", 1265 kVA , Copë 2 (Godina A2)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (90 lt secili)	litra	360
5	Mirëmbajtje dhe riparim i panelit të automatikës së 2 gjeneratorëve të spitalit A2	Orë pune	200
II C/2	Motogjenerator Tip "C.T.M GARIBOLDI", 1.000 kVA, Copë 2 (Godina A1)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	Copë	4
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (60 lt secili)	litra	240
5	F.V bateri 250 A, 24 V	Copë	8
6	Mirëmbajtje dhe riparim i panelit të automatikës së 2 gjeneratorëve të spitalit A1	Orë pune	200
II C/3	Motogjenerator Tip "FMT Generator", 178 kVA, Copë 1 (Depo Farmaceutike)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (20lt)	litra	40
II C/4	Motogjenerator Tip "Pramal", 220 kVA, Copë 1 (Francez)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (20lt)	litra	40
II C/5	Motogjenerator Tip " FMT Generator", 560 kVA, Copë 1 (Urgjenca e Pediatriisë)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2

4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (25lt)	litra	50
II C/6	Motogjenerator Tip " KZ Power", 600 kVA, Copë 1 (Pediatri e Specialiteteve)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (30lt)	litra	60
II C/7	Motogjenerator Tip "FMT Generator", 760 kVA, Copë 1 (Infektiv)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (40lt)	litra	80
II C/8	Motogjenerator Tip "Bruno" 66 kVA, Copë 1 (Onkologjik)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (8 lt)	litra	16
II C/9	Motogjenerator Tip "FMT Generator", 200 kVA, Copë 1 (Akseleroret Onkologjik)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (20lt)	litra	40
II C/10	Motogjenerator Tip "Teksan", 159 kVA, Copë 1 (Neurokirurgji)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (15t)	litra	30
II C/11	Motogjenerator Tip "FMT Generator", 275 kVA, Copë 1 (Akseleratori Neurokirurgji)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
3	F.V filter ajri sipas tipit të gjeneratorit	Copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (35lt)	litra	70
II C/12	Motogjenerator Tip "Kurkçuoğlu jenerator", 200 kVA, Copë 1 (Angiografi Neurologji)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (20lt)	litra	40
II C/13	Motogjenerator Tip " FMT Generator", 400 kVA, Copë 1 (Kardiokirurgji dhe Kirurgji Vaskulare)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	1

2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	1
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	1
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (28lt)	litra	56
II C/14	Motogjenerator Tip "Mecc Alte", 300 kVA, Copë 1 (Spitali 6-katësh)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (20lt)	litra	40
II C/15	Motogjenerator Tip "Mossa", 110 kVA, Copë 1 (Spitali 6-katësh)		
1	F.V filtër vaji sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
2	F.V filtër naftë sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
3	F.V filtër ajri sipas tipit të gjeneratorit	copë	2
4	F.V vaj lubrifikant sipas tipit të gjeneratorit (10 lt)	litra	20
III	UPS		
III/A	Shërbime mirëmbajtje periodike për të gjithë UPS		
1	Kontrolle dhe shërbime mirëmbajtje, sipas specifikimeve dhe kërkesave teknike	Orë pune	792
2	F.V filtra ajri	copë	24
3	F.V ventilatore	copë	5
4	F.V siguresa	copë	12
5	F.V kontaktore/ rele termike	copë	6
6	F.V bateri (12V, 9Ah–12Ah sipas konfigurimit)	copë	10
7	F. kondensatorë	copë	2
8	F.V panel komandimi për UPS 125 kVA	copë	1
9	F.V panel komandimi për UPS 60 kVA	copë	1

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Mirëmbajtje Impjantesh Elektrike për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, sipas specifikimeve teknike

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

-
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

N.S- 14. A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë/ministrisë kompetente, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 1 (një) inxhinier elektrik/ elektronik
- b. 1 (një) punonjës të kualifikuar si ekspert zjarrfikës, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
- c. 1 (një) punonjës teknik elektrik për sigurimin Teknik dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.
- d. 1 (një) punonjës të licencuar apo certifikuar/kualifikuar për “Mirëmbajtje gjeneratorësh”.

Për punonjësın në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësın në pikën b, c, d duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar/ dokument licencimi/certifikimi/kualifikimi (të vlefshme)

Punonjësit e kërkuar në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa profile.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH EN ISO 14001 "Sisteme të menaxhimit të mjedisit" ose ekuivalente/të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër realizimin e shërbimit objekt prokurimi sipas kushteve të kërkuara në specifikime teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
